



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	01-Nr-01/2018
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	09.03.2018

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive "KKSBB" – Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSBB).

Takimi filloi në ora 13.00

Takimin e kryesoi - Kryetari i Komunës, Bali MUHARREMAJ

Në takim morën pjesë :

Milazim Lumi- Komandant në Stacionin Policor në Therandë
 Isak Demiri-përfaqësues i FSK-së
 Halim Shehu -Komuniteti Islam
 Enver Shabani - Drejtorja e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë
 Adelina Tafolli-Përfaqësuese e OJQ-së
 Nuhi Llugaxhiu-përfaqësuesi EVSB-ve
 Shyqeri Fondaj-Kryetar i KPAK-së
 Brahim Thaqi – mediat lokale
 Sami Jupaj-Përfaqësues i KSH-së
 Fetije Bytyqi-Përfaqësuese e KLSP-së
 Remzi Bytyqi-Drejtor i Arsimit
 Habibe Bytyqi-Zyrtare për barazi gjinore
 Xheladin Sadikaj-Përfaqësues i zyrës KKK-së
 Hanife Bytyqi-Përfaqësuese e KPAK-së
 Zekë Berisha-Përfaqësues i KRE-ja
 Antigona Sofra-Kryesues i KK-së dhe përfaqësuesi KA-li
 Shefqet Kuçi-Komuniteti i biznesit

Në takim munguan:

Don Robert Jakaj-Komuniteti Katolik

REND DITE

1. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës
2. Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës për vitin paraprak
3. Trajtimi i qenve endacak

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës, z. Bali Muharremaj

Kryetari – përshendet të pranishmit si i njofton me rendin e ditës. Kërkon të votohet rendi i ditës

Unanimisht Aprovohet

Pika e I - Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës

Kryetari – njofton për takimin e parë si dhe iu uron suksese anëtarve. Kryetari gjithashtu kërkon përkrahjen e anëtarve për bashkëpunim për të ardhmën. Njofton për pikën e parë dhe dton Komandantin e policisë për elaborim.

Komandanti – njofton për sigurinë në Komunë, njofton për urdhresat e reja. Njofton për vizitat në shkolla. Njofton për sigurinë në komunë.

Kryetari – kërkon sygjerime nga anëtarët.

Brahim Thaqi – kërkon që raportet të dërgohen në kohë edhe mediave ashtu si institucioneve. Jep vërejtje për sinjalizimet, nuk mundet policia të shqipton gjoba nëse nuk ka shenja adekuate. Si dhe tek Viva nuk duhet sa shirita të rrugës janë, janë të ngatërruara. Jep vërejtje për trotuarët. Vjedhjet nëpër fshatra janë shumë shqetësuese. Thëkson që kjo KKSBB mos të përfundon vetëm me rekomandime por të ndërmerren masa. Për këtë edhe asamblesitet i kanë vërejtjet me vend për punën e KKSBB.

Enver Shabani – sektori i zjarreve është mirë të përmendet, pasi që është mirë ti kushtojmë vëmendje sidomos gjat sezonës së verës.

Avni Bytyqi – sqaron qështjen e raportimit në Kuvend

Brahim Thaqi – unë foli për raportimet shtesë

Komandanti – jep sqarime shtesë

Kryetari – jep konkluzionin – kam plan të kem një takim në mëngjes me Policinë, duhet të kemi bashkëpunim me komunitetin.

Për sinjalizim e kam bërë plani e veprimit, prioritet janë shkollat. Do të kërkoj nga Policia të jenë më shumë në teren.

Në takimin tjetër do ti analizojmë se a janë rritur këto shifra

Njofton për projektet rreth sigurisë

Brahim Thaqi – pyet për vendosjen e kamerave

Kryetari – njofton se është paraparë me buxhet

Rekomandime:

- a. Të rritet bashkëpunim në mes të policisë, komunitetit dhe institucionit
- b. Të rregullohen dhe riparohen shenjat e sinjalizimit
- c. Të vendosen kamerat në qytet

Enver Shabani – propozon të ndryhohen linja e autobusëve në orarin kur përfundon mësimi, në mënyrë që mos të presin shumë nxënës.

Remzi Bytyqi – oraret janë të caktuara nga Ministria, edhe ne kemi pasur vërejtje më herët.

Avni Bytyqi – njofton për orarin e autobusëve

Kryetari – kërkon të votohen rekomandimet

Aprovohen rekomandimet

Pika e II - Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Suharekës për vitin paraprak

Kryetari – njofton për pikën e dytë dhe fton Komandantin e policisë për elaburim

Komandanti – njofton për planin dhe veprimet për vjedhjet në komunë

Kryetari – duhet të keni bashkpunim me fshatrat

Brahim Thaqi – pyet se nëse nuk automjete si keni me i parandalu vjedhjet.

Komandanti – njofton për procedurat për vetura, nuk jemi kompetent për këtë, ne si stacion

Kryetari – edhe pse nuk është në rend ditë, janë shqetësuese edhe dëmtimet e pyjeve, ne duhet t'i shikojmë rregulloren dhe kemi mundësi të ofrojmë edhe veturat e komunës për ndihmë jasht orarit të punës.

Astrit Bytyqi – ne si QJQ kemi bërë dokumentare dhe fletushka, jep vërejtje në konfidencialitetin ndaj raportimeve të qytetarëve. Jep vërejtje për mësimdhënësit që dalin me nxënësit në kafeteri dhe pijnë cigare së bashku me nxënës.

Komandanti - jep sqarime shtesë

Halim Shehu – propozon të vetëdijësohen qytetarët për dukurit negative.

Kryetari – jep rekomandimin

Rekomandim:

- a. Të rritet bashkpunimi në mes të policisë-fshatrave dhe komunitetit.

Kërkon të votohet rekomandimi

Aprovohet

Pika e III - Trajtimi i qenve endacak

Kryetari – njofton për pikën e tretë, për trajtimin e qenve dhe frekuentimi i tyre në qendër. Ne si bord nuk mundemi të marrim vendim për asgjësim sepse ligji thotë se qent duhet të trajtohen.

Brahim Thaqi – pyet se për gjendjen emergjente çfarë do të bëhet.

Kryetari – mundësit janë të vogla

Enver Shabani – njofton për thirrjet që janë marrë për këtë qështje. Është ndarë një fond për këtë qështje prej 1.3 milion euro nga Qeveria, por kush e fiton tenderin, nuk e dijme as ne.

Kryetari – njofton përpagesat e antarvë të KKSBB

Takimi përfundoi në ora **14:10h**

Rekomandimet që dolën nga ky takim janë:

Përfundimet e takimit:

Pikat	Aktiviteti	Përgjegjësi i aktivitetit	Kontribuuesit – Partnerët	Afatet	Vërejtje
1	(Shkruaj temën e aktivitetit)	(shëno emrin e anëtarit/ëve të cilëve iu është caktuar obligimi	Shëno kontribuuesit/ partnerët e caktuar	Shëno afatin e raportimit për zbatimin/ realizmin e vendimit	
2					

Detyrat administrative:

Nga një kopje e këtij procesverbali iu dërgohet MPB dhe MAPL, 5 ditë nga dita e takimit, në këto adresa (shëno adresat e personave konkret ku duhet të dërgohet procesverbali).

Të përpilohet komunikata për media dhe të dërgohet menjëherë (sot).

Procedimi i të dhënave të takimit në Ueb faqe.

Procesmbajtësja:

Kryesuesi i takimit

Shegë BAJRAKTARI

Bali MUHARREMAJ

V.V
